



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 807/5 prot.,

Datë 01.04.2025

V E N D I M
Nr. 425/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Gjergj Merini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-39424-02-27-2025, me objekt: “Blerje materiale ndërtimi”, me fond limit 1.664.850 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 11.03.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shijak
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me Nipt M113130290 dhe adresë: Rr. “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shijak
Adresa :“Lagja “Erzen” Shijak
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi “Bajro Bros” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-39424-02-27-2025, me objekt: “Blerje materiale ndërtimi”, me fond limit 1,664,850 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë), zhvilluar në datë 11.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 11.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 18.03.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Biotek” sh.p.k	1,425,150	lekë s’kualifikuar
2. “General-Plus” sh.p.k.	1484900	lekë s’kualifikuar

3. “Bajro Bros” SHPK	1,546,600	lekë s’kualifikuar
4. Ervin Luzi	1,189,000	lekë s’kualifikuar
5. “Doksani-G” sh.p.k.	1,614,300	lekë s’kualifikuar
6. Sark” SHPK	1,564,450	lekë s’kualifikuar
7. Naim Hysi	1,531,070	lekë s’kualifikuar
8. “Alb-Korrekt”	1,419,680	lekë s’kualifikuar

II.4. Në datën 20.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “*Formularin e Njoftimit të anullimit të procedurës*” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyetimin se në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

II.5. Në datën 26.03.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik elektronik A/2025/5158 dhe me Nr. 807/2025 Prot., datë 26.03.2025 e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK “,ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij, nga procedura e prokurimit të sipërcituar me argumentimin si vijon:

“-Ne dokumentat e tenderit ne fjale, tek kerkesat per kualifikim, pika 2.2.a, thuhet: a. operatori ekonomik te paraqese vertetim nga administrata tatimore per xhiron mesatare vjetore te viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku te pakten ne njerin nga keto vite, xhiro minimale duhet te jete jo me pak se 40 % e fondit limit qe prokurohet. (kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatori ekonomik arrin vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor). ne nenin 43 te 2. VKM per RRPP, nr. 285, dt 19.05.2021 i ndryshuar, pika 2.c, thuhet: vlere e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operateve ekonomike nuk mund te tejkaloje: 40 % te vleres se perlllogaritur te kontrates ose lotit, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetary, dhe ne piken 3 thuhet: kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatet ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor. se pari, i kujtojme KVO - se qene daten e hapjes se procedures, dt 11.03.2025, bilaci i vitit 2024 nuk eshte mbyllur akoma , dhe rrjedhimisht, me aplikimin ne e albania per xhiron vjetore te tre viteve te fundit, xhiroja e vitit 2024, nuk pasqyrohet. dhe se dyti dhe me kryesorja, sic shihet edhe ne parashikimet ligjore te lartpermendura, ligjvenesit, e ka parashikuar qe ne proceduren e hapur e thjeshtuar, mund te marrin pjese edhe bizneset e vogla dhe konkurojne oe te cilet mund te jene shoqeri te reja, duke i dhene mundesi te paraqesin minimalisht xhiron vjetore te nje viti dhe kjo xhiro te jete jo me e vogel se 20% e fondit limit. Ne oferte shoqeria jone ka paraqitur xhiron vjetore te viteve 2021, 2022, 2023, ku shikohet qe xhiroja mesatare e dy viteve 2022 dhe 2023 eshte rreth 27350000 leke , pra disa here me e larte se kerkesa e ak. pra edhe sikur xhiroja e vitit 2024, te ishte 0 leke, kekesa e dt, konsiderohet e plotesuar nga oe bajro bros. gjithashtu, vete ak ne dt tek kerkesat per kualifikim ka thene: kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatori ekonomik arrin vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor. Ne keto kushte , vleresimi i kvo- se per oferten tone eshte i gabuar dhe ne shkelje te ligjit, RRPP, dhe DT ne fjale.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 807/1 prot., datë 27.03.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 807 prot, datë 26.03.2025.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1664 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 807/2 prot., datë 01.04.2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA-së lidhur me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK ku rezulton se ankesa e tij nuk është pranuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga AK me argumentimin se:” *Ne dokumentat e tenderit ne fjale, tek kerkemat per kualifikim, pika 2.2.a, thuhet: a. operatori ekonomik te paraqese vertetim nga administrata tatimore per xhiron mesatare vjetore te viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku te pakten ne njerin nga keto vite, xhiro minimale duhet te jete jo me pak se 40 % e fondit limit qe prokurohet. (kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatori ekonomik arrin vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor). ne nenin 43 te 2. VKM per RRPP, nr. 285, dt 19.05.2021 i ndryshuar, pika 2.c, thuhet: vlere e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operateve ekonomike nuk mund te tejkaloje: 40 % te vleres se perlllogaritur te kontrates ose lotit, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetary, dhe ne piken 3 thuhet: kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatet ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor. se pari, i kujtojme KVO - se qene daten e hapjes se procedures, dt 11.03.2025, bilaci i vitit 2024 nuk eshte mbyllur akoma , dhe rrjedhimisht, me aplikimin ne e albania per xhiron vjetore te tre viteve te fundit, xhiroja e vitit 2024, nuk pasqyrohet. dhe se dyti dhe me kryesorja, sic shihet edhe ne parashikimet ligjore te lartpermendura, ligjvenesit, e ka parashikuar qe ne proceduren e hapur e thjeshtuar, mund te marrin pjese edhe bizneset e vogla dhe konkurojne oe te cilet mund te jene shoqeri te reja, duke i dhene mundesi te paraqesin minimalisht xhiron vjetore te nje viti dhe kjo xhiro te jete jo me e vogel se 20% e fondit limit. Ne oferte shoqeria jone ka paraqitur xhiron vjetore te viteve 2021, 2022, 2023, ku shikohet qe xhiroja mesatare e dy viteve 2022 dhe 2023 eshte rreth 27350000 leke , pra disa here me e larte se kerkesa e ak.*

pra edhe sikur xhiroja e vitit 2024, te ishte 0 leke, kekesa e dt, konsiderohet e plotesuar nga oe bajro bros. gjithashtu, vete ak ne dt tek kerketat per kualifikim ka thene: kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatori ekonomik arrin vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor. Ne keto kushte , vleresimi i kvo- se per oferten tone eshte i gabuar dhe ne shkelje te ligjit, RRPP, dhe DT ne fjale”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

“a. Operatori ekonomik te paraqese vertetim nga administrata tatimore per xhiron mesatare vjetore te viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku të paktën në njërin nga këto vite, xhiro minimale duhet te jete jo me pak se 40 % e fondit limit që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor). ”

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi, se në funksion të plotësimit të kriterit 2.2.a të mësipërm, operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, ka dorëzuar vërtetimin Nr. T12720825, datë 10.03.2025, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, me përmbajtje si më poshtë:

“Vërtetojmë se Personi Juridik/ Fizik [...] Tatimpaguesi: PC Store [...], në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

<i>Periudha Tatimore</i>	<i>Shuma</i>
23-A	25,956,306
22-A	28,746,101
21-A	23,615,688

Ky vërtetim lëshohet për pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohet në datën 11.03.2025, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Bashkia Shijak, me objekt prokurimi: “Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë: 1,648,50 lekë, me vendndodhje në Shijak.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.4. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tri) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.8. Në Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr. Nr. T127208258, datë 10.03.2025, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2021, 2022 dhe 2023 e subjektit “Bajro Bros” SHPK.

Rezulton, se për vitet 2022 dhe 2023, xhiroja vjetore e shoqërisë ka qenë disa herë më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor që: *“vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2022, 2023, 2024) duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht: 665 940 lekë”*. Që të quhej i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor për xhiron, operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK duhet të plotësonte kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit 2022, 2023, 2024, ndërkohë që operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK e përmbush dhe e tejkalon kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 2.2.a. *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, pasi vlera e xhiros për vitet 2022 dhe 2023 është shumë herë më e madhe se 40% e fondit limit. Pra qëllimi për të cilin autoriteti kontraktor vendos në kriteret e veçanta një kërkesë të tillë, është të vërtetojë se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të operatorit ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, të jetë jo më i vogël se 40% e fondi limit, kështu që rrjedhimisht, OE ankimues, me dokumentacionin e paraqitur vërteton përmbushjen e këtij kriteri.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-39424-02-27-2025, me objekt: “Blerje materiale ndërtimi”, me fond limit 1.664.850 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 11.03.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shijak.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK, duke e kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri